



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 27, datë 12.06.2026



**PËR MIRATIMIN E NGRITJES DHE FUNKSIONIMIT TË “QENDRËS PËR SHËRBIME MBËSHTETËSE PËR FËMIJËN DHE FAMILJEN” ME MBËSHTETJEN NGA PROGRAMI I FONDIT SOCIAL TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR VITET 2026-2028 DHE BUXHETI I BASHKISË DURRËS**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Deklaratën e Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën e të Drejtave të Fëmijëve, Ligjit nr. 121/2016, “Për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, VKM-së nr. 658, datë 17.10.2005 “Për Standartet e Shërbimeve Shoqërore”, Udhëzimin nr. 911, datë 27.12.2018 “Për miratimin e Standarteve të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror në Qendrat Komunitare Shumëdisiplinore”, Planit Social Vendor 2025–2028 të Bashkisë Durrës, Marrëveshjen e bashkëpunimit Nr.2420 prot, datë 18.02.2026 të lidhur ndërmjet Bashkisë Durrës dhe Shërbimit Social Shtetëror për zbatimin e projektit: “Qendër për Shërbime Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen”, mbështetur financiarisht nga programi i Fondit Social, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**VENDOSI:**


1. Ngritjen dhe funksionimin e Qendrës për “Shërbime Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen” me një strukturë prej 5 punonjësish.

2. Fondin e shpenzimeve të personelit dhe shpenzimeve operative për Qendrën për “Shërbime Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen” për vitin 2026 është 5,241,680 lekë e financuar nga Fondi Social, alokuar nga Buxheti i Shtetit, i ndarë si më poshtë vijon:
  - Për paga (llogaria ekonomike 600) 4,308,128 lekë.
  - Për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (llogaria ekonomike 601) 708,384 lekë.
  - Për shpenzime operative (llogaria ekonomike 602) 225,168 lekë.
3. Niveli i pagave të këtyre punonjësve është sipas lidhjes nr. 5, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.17, datë 02.04.2026 “Për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e institucioneve në varësi të Bashkisë”.
4. Veprimet financiare të kësaj qendre do të kryhen nga nëpunësi zbatues i nivelit të dytë pranë Qendrës Ditore të të Moshuarve.
5. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Buxhetit, Qendra Ditore e të Moshuarve, Qendra për Shërbime Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen (SHMFF) .

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR**

**Denisa Luarasi**




**U shpall sot me datë 15.06.2026**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS



Nr. 417/6 prot.

Durrës, më 22.06.2026

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS ✓

KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.27 datë 12.06.2026, ” Për miratimin e ngritjes dhe funksionimit të “Qendrës për Shërbime Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen” me mbështetjen nga programi i fondit social të buxhetit të shtetit për vitet 2026-2028 dhe buxheti i Bashkisë Durrës ”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI  
ADRIAN GURRA

